

Nëntor 2024 | Nr. 43

# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

[www.ild.al](http://www.ild.al) | [info@ild.al](mailto:info@ild.al)



Inspektori i Lartë i  
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani  
@ILD\_Albania

**ILD: PROCESI DISIPLINOR NUK MUND TË JETË STATISTIKË,  
POR STANDARD I QËNDRUESHËM PUNE QË I SHËRBEN SISTEMIT**





## **ILD: PROCESI DISIPLINOR NUK MUND TË JETË STATISTIKË, POR STANDARD I QËNDRUESHËM PUNE QË I SHËRMBEN SISTEMIT**

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Komiteti Shqiptar të Helsinkit, mbi punën e këtij raporti, në të cilin janë paraqitur gjetje institucioneve të drejtësisë, për dy prej të cilave, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, ka hartuar një raport pas monitorimit të bërë veprimtarisë së tyre gjatë vitit 2023.

Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbajtur nga Inspektore magjistrate znj. Elena Pelushi:

Përshëndetje të gjithëve,

Në emër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

dua të falenderoj Komitetin Shqiptar të Helsinkit për këtë organizim dhe hartimin e këtij raporti, në të cilin janë paraqitur gjetje nga monitorimi që i është bërë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2023. Vlerësime ekipit të ekspertëve të këtij Komiteti për punën e bërë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë e vlerëson si tejet të rëndësishëm rolin e organizatave të shoqërisë civile, në monitorimin e punës së institucioneve të drejtësisë dhe Komiteti i Helsinkit është një nga gjashtë organizatat, me të cilat ILD ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mars të vitit 2022, me synim rritjen e performancës së

***Inspektori i Lartë i Drejtësisë e vlerëson si tejet të rëndësishëm rolin e organizatave të shoqërisë civile, në monitorimin e punës së institucioneve të drejtësisë dhe Komiteti i Helsinkit është një nga gjashtë organizatat, me të cilat ILD ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mars të vitit 2022, me synim rritjen e performancës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.***

Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes rritjes së komunikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta, në kuadër të monitorimit, analizimit, procesit llogaridhënës dhe ndërgjegjësues mbi veprimtarinë e Zyrës së ILD-së, përmes shkëmbimit të të dhënave, organizimit të takimeve periodike, ofrimit të ekspertizës përkatëse të OSHC-ve të specializuara.

Prandaj për ne është me shumë interes, të njihemi me këndvështrimet e aktorëve të jashtëm, të reflektojmë mbi to, e të përfitojmë prej tyre dhe të ofrojmë çdo sqarim të nevojshëm, për të kuptuar natyrën e punës së një institucioni aq specifik, siç është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Meqenëse veprimtaria e vitit 2023 është në qendër të këtij raporti, dua të sjell në



***Gjatë vitit 2023, 1/3 e procedimeve të nisura, evidentuar saktë në raportin e paraqitur, kanë qenë me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një ilustrim se institucioni ynë mbetet i vëmendshëm edhe ndaj informacionit që bëhet publik, krahas analizimit të problematikave që evidentojmë nga ankesat direkte të qytetarëve a institucioneve.***

vëmendje se ky vit ka pasur ngarkesë të paraqitur, kanë qenë me iniciativë të lartë pune për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një të Drejtësisë, për shkak se arritëm të ilustrim se institucioni ynë mbetet i përfundonin plotësisht trajtimin e vëmendshëm edhe ndaj informacionit që backlogut, pra kontigjentin prej 2104 bëhet publik, krahas analizimit të çështjesh, që ILD trashëgoi nga institucionet problematikave që evidentojmë nga e mëparshme. ankesat direkte të qytetarëve a institucioneve. Thënë kjo, Zyra e Inspektorit

Paralelisht është vijuar me trajtimin e të Lartë të Drejtësisë e nënvizon ankesave të ardhura nga qytetarët dhe vazhdimisht, se tek një informacion publik kryerjen e inspektimeve, ndërsa nuk ka mund të paraqiten një tërësi faktesh, të patur ndryshime në plotësimin e trupës së cilat pretendohet se kanë ndodhur dhe që inspektorëve, një mangësi që vijon të përbëjnë shkelje disiplinore, por është mbetet një sfidë permanente për Inspektorin i Lartë i Drejtësisë, ai që mund të veprimtarinë e ILD-së. Në muajin shkurt bëjë një cilësim të saktë apo të ndryshëm të 2023, institucioni i ILD-së është zhvendosur fakteve dhe veprimeve, që lidhen me në ambiente të ndryshme pune, për shkak shkeljen disiplinore, pa u lidhur me të rikonstruksionit të godinës, kjo sa për një përcaktimin, që mund të pretendohet në panoramë të kushteve në të cilat është këtë informacion publik.

ushtruar veprimtaria deri në muajin tetor të 2024-ës.

Megjithatë puna ka vijuar me të njëjtat parametra standardesh, duke u kujdesur për të kënaqur këdo që e mat punën e një për parimin kryesor të punës sonë, ruajtjen institucioni me numra. Inspektorin i Lartë i Drejtësisë vijon të mbetet i përkushtuar tek standardet që vendos, duke shqyrtuar interesat e ligjshme, si të ankuesit, ashtu edhe të magjistratit, duke gjykuar në

Gjatë vitit 2023, 1/3 e procedimeve të mënyrë proporcionale dhe duke nisura, evidentuar saktë në raportin e dokumentuar të gjitha provat dhe dëshmitë



e paraqitura dhe duke respektuar të drejtat e magjistratit objekt hetimi.

Kjo pasi masat disiplinore kanë dy funksione, së pari, rolin edukues, përmes të cilit, i silltet në vëmendje edhe magjistratëve të tjerë, standardi i duhur i punës, e së dyti, kur ky rol edukues nuk mund të kryhet, atëherë masa kthehet me natyrë të pastër ndëshkuese, duke marrë përsipër mbrojtjen e interesit publik, e larguar nga detyra magjistratin.

Në punën e vet, ILD udhëhiqet nga parimi se ky institucion nuk mund të jetë një çekan mbi kokat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por nga ana tjetër, nuk anashkalon në asnjë rast, ata gjyqtarë e prokurorë që shkelin ligjin, duke cënuar figurën e magjistratit dhe besimin e qytetarëve tek drejtësia.

Ju faleminderit!

***Në punën e vet, ILD udhëhiqet nga parimi se ky institucion nuk mund të jetë një çekan mbi kokat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por nga ana tjetër, nuk anashkalon në asnjë rast, ata gjyqtarë e prokurorë që shkelin ligjin, duke cënuar figurën e magjistratit dhe besimin e qytetarëve tek drejtësia.***



## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKOI TË NGARKUARËN ME PUNË TË AMBASADËS SË SHBA NË SHQIPËRI

Postimi i Ambasadës së SHBA-së, pas takimit:

“E Ngarkuara me Punë Nancy VanHorn u takua me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) z. Artur Metani për të riafirmuar mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për rolin jetik të ILD-së në mbikëqyrjen e sjelljes dhe profesionalizmit të gjyqtarëve, prokuro-

rëve dhe anëtarëve të këshillave. Znj. VanHorn nxiti ILD-në të ruajë ecurinë pozitive në zbatimin e reformës në drejtësi dhe theksoi rëndësinë e respektimit të standardeve të larta të vendosura gjatë procesit të rivlerësimit në muajt dhe vitet në vijim”.





## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PRITI AMBASADORIN E RI TË OSBE NË SHQIPËRI

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe dinamikat e veprimtarisë së tij, si institucioni përgjegjës për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve e prokurorëve në vend dhe iu përgjigj interesit të ambasadorit Tarran mbi funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë aspekte të rolit të ILD-së.

***Z. Metani e njohu ambasadorin e OSBE me funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe dinamikat e veprimtarisë së tij, si institucioni përgjegjës për shkeljet disiplinore të gjyqtarëve e prokurorëve në vend dhe iu përgjigj interesit të ambasadorit Tarran mbi aspekte të rolit të ILD-së.***





Bashkëbiseduesit vlerësuan bashkëpunimin dhe pritshmëritë në raport me sjelljen e e deritanishëm mes Zyrës së ILD-së dhe magistratëve në sistem.

Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, në funksion të strategjisë së komunikimit të Z. Metani dhe z. Tarran u angazhuan ta vi Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë joinë bashkëpunimin institucional, edhe në për paraqitjen e institucionit tek grupet e projekte të tjera me ndikim në punën e ILD-ndryshme të interesit, aty ku ata jetojnë së, e më tej në rritjen e forcimin e besimit dhe diskutuar me ta mbi mënyrën se si e të publikut tek sistemi i drejtësisë. shohin rolin e institucionit, eksperiencat

***Bashkëbiseduesit vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm mes Zyrës së ILD-së dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, në funksion të strategjisë së komunikimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për paraqitjen e institucionit tek grupet e ndryshme të interes.***



## NJOFTIM

Me përfundimin e rikonstruksionit të deri në stabilizimin e plotë të stafit të Zyrës godinës, Zyra e Inspektorit të Lartë të së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Drejtësisë rikthehet në ndërtesën e vet, në adresën **Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë.**

Falenderojmë qytetarët për mirëkuptimin, mbi ndikimin që do ketë procesi i trans-ferimit në oraret e pritjes e komunikimit, 14.00.

***Oraret për komunikimin me qytetarët që duan informacion apo të paraqesin ankesë pranë ILD-së mbeten të pandryshuara. Ekipi i Zyrës së ankesave do i mirëpresë çdo ditë pune nga ora 09.00 – 14.00.***

## NËNTORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Nëntor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **67 ankesa, 60 nga qytetarë dhe 7 nga institucione**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit nwntor 2024.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
<p><b>103 praktika të trajtuara</b> nga të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 24 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (53 praktika të bashkuara)</li> <li>• 17 vendime arkivimi pas verifikimit (9 ankesa të bashkuara)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 21 vendime verifikimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 4 vendime për fillim hetimi disiplinor ( 3 gjyqtarë 1 prokuror)</li> <li>• 1 vendim përfundim hetimi disiplinor (prokuror)</li> </ul>

## ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

\* mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;

\* të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al) ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

\*

\* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

## SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Tetor 2024** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **5 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





### Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



**Gjatë muajit Nëntor 2024, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun:**

- ⇒ ka pritur **28 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe
- ⇒ ka realizuar **1 telefonatë me qytetarë**, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit [amanta.jasa@ild.al](mailto:amanta.jasa@ild.al).

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

## SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Nëntor 2024, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **22 kërkesa për informacion**, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ILD NË TWITTER

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani reposted



**U.S. Embassy Tirana**  
@USEmbassyTirana

Follow

Chargé d’Affaires Nancy VanHorn met with High Justice Inspector (HJI) Mr. Artur Metani to reaffirm the United States' support for the HJI's vital role in overseeing the conduct and professionalism of judges, prosecutors, and council members. Ms. VanHorn encouraged the HJI to maintain the positive momentum in implementing justice reform and emphasized the importance of upholding the high standards established during the vetting process in the months and years to come.



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Kënaqësi njohja dhe bashkëbisedimi me ambasadorin e ri të #OSBE në #Shqipëri, diplomatit e karrierës z. Michel Tarran.  
#ILD @OSCEinAlbania @OSCEambAL

Translate post



From ild.al



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Why the disciplinary process cannot be a statistics? #HIJ



HIJ: THE DISCIPLINARY PROCESS CANNOT BE A STATISTI...

From ild.al



**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M...**  
@ILD\_Albania

Upon the completion of the reconstruction of the office building, The Office of the High Inspector of Justice returns to its own headquarters, at the address: Boulevard “Dëshmorët e Kombit”, Building no. 13, Tirana.



From ild.al

9:53 AM · 1.11.24 From Earth · 48 Views

## NËNTOR 2024

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD



## KONTAKT ILD

WEB: [ild.al](http://ild.al)

EMAIL: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin  
prezantues të ILD*

